



Nr. 6/1 prot.
Dt. 05/02/2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



Nr. Serial 000203

LEJE
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR

Nr. 39 Prot., datë 05/02/2024

Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 04 , datë 31/01/2024

Emri i individit/subjektit: "SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES
KANALIZIME POGRADEC" sh.a

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): M24416601U

Baseni Ujor: DRIN-BUNË

Qarku: KORÇË

Bashkia/ Njësia administrative: POGRADEC / UDENISHT

Koordinatat e vepres së marrjes X = 552626 Y = 4549035 Z = 702 m

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për ujë të pijshëm
(sisteme të furnizimit me ujë të popullatës)

Prurja mesatare vjetore: 70 l/s

Prurja ekologjike: 50 l/s

Sasia e ujit që jepet për përdorim: 20 l/s

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) 1/s

Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer:

Vendi i shkarkimit të ujrave të përdorura:

Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes): (ha)

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): Sipas Kushteve të Lejes

Periudha e vlefshmërisë: 5 Vjet

Hyrja në fuqi Pas publikimit në Rregjistrin
Kombëtar të Licencave dhe
Lejeve.

KRYETARI

MAJLINDA ANGONI



Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujqor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes.
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontroleve nga autoritetet përkatëse të ujit
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje apo autorizim.
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujqor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujqor në gjëndjen e mëparshme.
14. Të mos cënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla.
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për përdorimin e burimit ujqor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur.
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore për veprimtarinë përkatëse.